



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 1754/1 Prot.
12

Tiranë, më 09.11 2022

V E N D I M

Nr. 227 dt. 09.11 2022

**PËR SHPALLJEN E KONKURSIONIT PËR PRANIMIN E 1 (NJË) PUNONJËSI,
PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME "ASISTENT LEKTOR" NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT PRANË UNIVERSITETIT TË
SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanatit të FSHR me nr. 1754/1 prot., datë 07.11.2022 "Kërkesë për hapje konkursi për punonjës si personel akademik me kohë të pjesshme në FSHR, për vitin akademik 2022-2023", Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në web-in <http://www.ust.edu.al> të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Shkencave Biomjekësore dhe Humane në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI I SHKENCAVE BIOMJEKËSORE DHE HUMANE

1. Formim Ndërdisciplinor (Mod. Farmakologji) "Bachelor" 1 (një) Asistent Lektor.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për "Asistent Lektor" në lëndën: **Formim Ndërdisciplinor (Mod.Farmakologji)**, janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2. Kandidati duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për arsimin në Shqipëri).

3. Kandidati duhet të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave mbi 8.
4. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
5. Të mos ketë prishur apo cënuar imazhin e UST-së.
6. Dëshmi penaliteti/formulari i vetëdeklarimit.

Kritere specifike:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare në Fakultetin e Farmacisë me notën mesatare mbi 8 (tetë).
2. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit.
3. Vlerësohen specializime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së farmakologjisë.
4. Të ketë 2 (dy) referenca nga profesorë të fushës.

Kritere preferenciale:

1. Të ketë eksperiencë mësimdhënie në IAL.

II. Kandidatët që do të aplikojnë për këtë vend pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon;
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëhësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues);
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve të shpallura:

- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti dhe Departamenti ku konkuron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

IV. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.

V. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.

VI. Deri në datën 16.11.2022, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 18.11.2022 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.

VII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.

VIII. Dekanati i FSHR-së, përcjell listën përfundimtare brenda datës 23.11.2022, për miratim në Rektorat.

IX. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Administratori, Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FSHR-së, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *web-in* <http://www.ust.edu.al>.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

